

# GOLI OTOK



**UDHËZUES I SHKURTËR PËR HISTORINË  
E KAMPIT NË GOLI OTOK**

## Zyra Rajonale e Fondacionit Friedrich Ebert në Zagreb

Fondacioni Friedrich Ebert (FES) është fondacioni më i vjetër politik në Gjermani, i themeluar në vitin 1925 duke u mbështetur në trashëgiminë politike të kryetarit të parë të zgjedhur në mënyrë demokratike në Gjermani, Friedrich Ebert. Puna jonë arsimore dhe akademike mbështetet në idetë dhe vlerat themelore të social-demokracisë, si: liria, drejtësia dhe solidariteti. Në këtë drejtim, ne mundësojmë bashkëpunimin ndër-kombëtar, shkëmbimin e ideve mbi social-demokracinë dhe mbështesim punën e sindikatave të pavarura.

Zyra Rajonale e Fondacionit Friedrich Ebert në Zagreb është hapur në vitin 1996 dhe është përgjegjëse për projektet në Kroaci dhe Slloveni. Elementet kryesore të punës sonë janë: forcimi i institucioneve demokratike, krijimi i koncepteve të reformave ekonomike dhe sociale në bashkëpunim me institucionet partnere në Kroaci, mbështetja e dialogut dhe pajtimit ndëretnik, mbështetja dhe promovimi i aktiviteteve të sindikatave dhe mbështetja e organizatave që punojnë në zhvillimin e një shoqërie civile aktive dhe pluraliste.

## Documenta - Qendra për Ballafaqimin me të Kaluarën

Documenta - Qendra për Ballafaqimin me të Kaluarën është themeluar në vitin 2004 me qëllim që të nxit procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe forcimin e dialogut publik mbi ngjarjet historike traumatike që shënuan shekullin e 20-të në shoqërinë kroate dhe evropiane. Documenta i kushton vëmendje të veçantë vuajtjeve të individëve dhe të grupeve shoqërore në luftëra dhe viktimave të dhunës së motivuar ideologjike në Kroaci dhe vendet fqinje.

Në ndërtimin e pluralizmit demokratik dhe të një shoqërie të paqes, Documenta bashkëpunon me një numër të madh të institucioneve publike, organizatave joqeveritare dhe të mediave në Kroaci dhe vende të tjera. Aktivitetet e Documenta janë të organizuara në tre programe themelore: (1) Dokumentimi, (2) Dialogu publik dhe politik publik, dhe (3) Përmirësimi i standardeve dhe praktikave gjyqësore.

# GOLI OTOK

## UDHËZUES I SHKURTËR PËR HISTORINË E KAMPIT NË GOLI OTOK

### Dr. sc. Martin Previshiq

Docent në Departamentin e Historisë të Fakultetit Filozofik në Zagreb

### Dr. sc. Boris Stameniq

Koordinator i programit „Kultura e Kujtesës“ Documenta - Qendra për Ballafaqimin me të Kaluarën

### Vladi Braliq, dipl. ing. arh

Doktorant në Fakultetin e Arkitekturës në Zagreb

## Përmbajtja

Pse është i nevojshëm një botim për Goli Otokun?	2
Pse e kujtojmë Goli Otokun?	3
Konteksti historik i krijimit të kampit në Goli Otok	5
Goli Otok 1949 – 1956	7
Goli Otok 1956 – 1988	9
Vizita e Goli Otokut në 60 minuta	10
1 - Moli	12
2 - Hoteli	13
3 - Teli i Madh	14
4 - Qendra e vetë-administrimit të kampit	15
5 - Gropa e Petarit	16
6 - Rezervuari i ujit	17
7 - Punëtoritë	18
8 - Ndërtesa prej guri	19
Kampi për gra	21
Goli Otok – sekretit publik jugosllav	25
Goli Otoku në kulturën bashkëkohore kroate të kujtesës	27
Literaturë	31
Harta gjeografike e Goli Otokut	32

## **Pse është i nevojshëm një botim për Goli Otokun?**

Për Fondacionin Friedrich Ebert, një institucion që angazhohet në arsimimin politik, historia gjithmonë është një fushë që ofron mësim. Kushdo që ballafaqohet me historinë duhet ta bëjë këtë me një interes të dyfishtë njohës: së pari për ta kuptuar se çfarë dhe kur ka ndodhur, për çfarë arsyes dhe me çfarë pasojash, por edhe për të nxjerrë mësim nga historia për të tashmen dhe të ardhmen. Ndër vite, FES së bashku me Departamentin e vet të Historisë, ka dhënë një kontribut të gjerë në studimin e historisë së fashizmit në Gjermani, historinë e lëvizjes së punëtorëve dhe protagonistët e saj kryesor, si dhe historinë shoqërore në përgjithësi.

Të udhëhequr nga paradigma e kritikës së historisë shkencore, Fondacioni Friedrich Ebert shpreson se kjo broshurë do t'ju ndihmojë të kuptoni se çfarë ndodhi në të vërtetë në këtë ishull të vogël të detit Adriatik, të quajtur Goli Otok, si dhe t'ju mundësojë të nxirrni mësim për të tashmen dhe të ardhmen.

Shpresojmë që nëse e lexoni këtë broshurë dhe së bashku me të vizitoni Goli Otokun, ju mund të përjetoni jo vetëm bukuritë natyrore të ishullit por edhe të kuptoni vuajtjet njerëzore që kanë ndodhur atje. Duke u ballafaquar me të kaluarën e Goli Otokut, ju do të kontribuoni që të mos harrohen vuajtjet e të burgosurve që kishin qëndruar atje midis viteve 1949 dhe 1956. Ju do të kuptoni se sa e papranueshme është të privosh njeriun nga liria vetëm se mendon ndryshe nga pushteti. Në fund të fundit, shpresojmë që kjo broshurë do t'ju nxit që të ngriheni për liri dhe solidaritet, si dhe kundër padrejtësisë dhe dhunës. Përzemërsisht falënderoj autorët e këtij botimi, Martin Previsiq, Vlado Braliq dhe Boris Stameniq, të cilët e kanë mundësuar këtë hulumtim të rëndësishëm historik për një grup të gjerë lexuesish. Gjithashtu falënderoj edhe Vesna Ibrishimović për dizajnin grafik të këtij botimi, si dhe Blanka Smoljan nga Fondacioni Friedrich Ebert për mbështetjen e saj të pasqorë, pa të cilën kjo broshurë nuk do të ishte e mundur të realizohej.

### **Türkan Karakurt**

Drejtoreshë e Zyrës së Fondacionit Friedrich Ebert në Zagreb

## **Pse e kujtojmë Goli Otokun?**

Goli Otoku është një vend i karakterizuar nga dhuna e regjimit komunist jugosllav kundër mijëra individëve të burgosur në ishull. Ky ishull i shkretë dhe i djerrë që gjendet midis ishujve Rab dhe Senj, është një nga vendet me rëndësinë më të madhe simbolike në historinë bashkëkohore të Kroacisë dhe të kohës së saj si republikë në ish-Jugosllavi. Mirëpo, nga kampi i mëparshëm dhe më vonë burgu në Goli Otok, kanë mbetur vetëm ndërtesa të shkatërruara ku delet kullosin në dimër, ndërsa turistët shëtisin në verë në kërkim të përvojës së "Alkatrazit Adriatik", vizita këto të cilat iu ofrohen turistëve nga agjencitë e udhëtimit ose pronarët vendor të anijeve.

Megjithëse pothuajse të gjithë në Kroaci kanë dëgjuar për Goli Otokun, pakkush mund të thotë më shumë sesa disa fjali kuptimplota për këtë ishull. Një nga arsyet më të rëndësishme për këtë mungesë informacioni qëndron në mungesën e kërkimit shkencor gjithëpërfshirës për Goli Otokun. Me botimin e librit "Historia e Goli Otokut" nga Dr. Martin Previsiq (Martin Previšić, "Povijest Golog otoka") në fillim të vitit 2019, u bë një hap i madh përpara në kërkimin shkencor mbi këtë temë të rëndësishme. Megjithatë, libri i Previsiqit me gjashtëqind e ca faqe tejkalon nevojat për informim të një vizitori mesatar apo publikut të gjerë.

Kjo broshurë është krijuar në bashkëpunim me Dr. Martin Previsiqin dhe paraqet një hyrje të shkurtër në temën e historisë politike të Goli Otokut, si dhe ofron një udhëzues për pjesën e ishullit që vizitorët më së shpeshti vizitojnë. Rezultatet shumëvjeçare të kërkimit shkencor të Dr. Previsiqit iu paraqiten lexuesve në një mënyrë të kuptueshme dhe të thjeshtë, të përshatshme për ata lexues që nuk kanë njohuri paraprake për Goli Otokun, ose historinë politike të Kroacisë.

Përveç ofrimit të informacionit themelor për kampin dhe më vonë burgun në Goli Otok, qëllimi i kësaj broshure është që të nxit lexuesit të mendojnë për dhunën e motivuar ideologjikisht në kuadër të regjimeve të ndryshme në Kroaci në shekullin e 20-të. Në të njëjtën kohë, dëshirojmë të theksojmë rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirisë së secilit individ, si dhe të nxisim ndjeshmërinë me viktimat e dhunës politike dhe ideologjike.

Ne e konsiderojmë edukimin e publikut së bashku me nxitjen e reflektimit kritik dhe dialogut publik si postulate themelore të ndërtimit të qytetarëve me ndërgjegje shoqërore, të gatshëm për të kundërshtuar cenimin e lirisë së shprehjes, mendimit dhe veprimit brenda kuadrit dhe rendit kushtetues e ligjor. Me këtë broshurë për Goli Otokun, dëshirojmë të kontribuojmë në zhvillimin e një shoqërie të mbështetur në vlera demokratike dhe qytetare, një shoqëri në të cilën Goli Otoku nuk do të ndodhë më kurrë.

**Dr. Boris Stameniq**

## KONTEKSTI HISTORIK I KRIJIMIT TË KAMPIT NË GOLI OTOK

Jugosllavia komuniste ishte një nga ndjekësit më besnikë të Bashkimit Sovjetik në vitet pas Luftës së Dytë Botërore. Komunistët jugosllavë u përpoqën të kopjonin modelin sovjetik në politikë, kulturë, ekonomi, gjyqësi, si dhe në shumë fusha të tjera. Fotografitë e Stalinit ishin një pamje e zakonshme në institucione të ndryshme shtetërore, ndërsa lavdërimi i pafund i Bashkimit Sovjetik dhe udhëheqësit të tij mbushnin hapësirën publike. Megjithatë, komunistët jugosllavë ishin të udhëhequr nga bindja se ata duhej të forconin rolin e tyre rajonal dhe të përhapin komunizmin përtej kufijve të Jugosllavisë. Kjo politikë i solli ata në konflikt me Bashkimin Sovjetik, të cilit nuk i pëlqenin veprimet e pavarura të Jugosllavisë në Greqi, Bullgari dhe Shqipëri. Më 28 qershor 1948, sovjetët nxorën Rezolutën e Informbyrosë që synonte të ushtronte presion mbi Jugosllavinë, duke shpresuar për një ndryshim në udhëheqjen e atëhershme. Meqë konflikti ishte sekret gjatë gjithë asaj kohe, publikimi i Rezolutës së Informbyrosë shkaktoi një tronditje në mesin e qytetarëve të vendit. Pas tre viteve të stalinizimit intensiv të Jugosllavisë, ishte vështirë të pranohej fakti që Bashkimi Sovjetik dhe Stalini nuk ishin më miq. Megjithatë, rënia e udhëheqjes së Partisë Komuniste nuk ndodhi. Sovjetët pastaj izoluan Jugosllavinë nga ana ekonomike dhe diplomatike, madje kishte shenja se ata mund të ndërhynin ushtarakisht. Në të njëjtën kohë, në vend filluan të shfaqeshin informbyroistët, mbështetës të Bashkimit Sovjetik, si dhe njerëz të cilët ishin të hutuar nga situata e re politike për shkak të anësisë në ofrimin e informacionit nga ana e qeverisë jugosllave. Gjysmë viti pas nxjerrjes së Rezolutës së Informbyrosë, kur u bë e qartë se nuk do të ketë pajtim me Bashkimin Sovjetik dhe se marrëdhëniet mund të pritej të përkeqësoheshin edhe më tej, komunistët jugosllavë filluan një ballafaqim me kundërshtarët e vërtetë dhe të pretenduar brenda radhëve të tyre dhe filluan organizimin e një sistemi të kampeve e burgjeve për të burgosur informbyroistët, më i madhi prej të cilëve ishte kampi në Goli Otok, i krijuar në korrik të vitit 1949.

Gjatë historisë, ishuj të shumtë në botë kanë shërbyer si vende për të burgosur kundërshtarët politikë. Ky ishull i izoluar në



detin Adriatik, i vendosur larg kufijve lindorë të Jugosllavisë, ishte zgjedhja e natyrsme për policinë sekrete jugosllave, e njohur si Shërbimi i Sigurimit të Shtetit (UDBA), si një zgjidhje logjike për të izoluar mbështetësit e vërtetë dhe të pretenduar të Stalinit. Meqenëse ishulli nuk ka ujë të pijshëm, si dhe toka dhe klima e tij janë të pafavorshme, ai nuk ishte as i banueshëm dhe as i përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë, përveç ndonjëherë për peshkim dhe mbarështimin e deleve. Pavarësisht se ndodhet në një pjesë të detit Adriatik relativisht të populluar, Goli Otoku, me një sipërfaqe prej 4,54 km<sup>2</sup>, mbeti i shkretë. Pjesa më e madhe e ishullit është e pambrojtur nga goditjet e erës, ndërsa vetëm një pjesë e bregdetit, ana jug-perëndimore në Goli Otok është pjesërisht e mbrojtur. Pikërisht në këtë pjesë ishte hyrja natyrore në ishull, e cila më vonë, gjatë krijimit të kampit, u përdor për të ndërtuar një liman. Pjesa tjetër e paarritshme e vijës bregdetare, veçanërisht ana veriore dhe lindore e ishullit, karakterizohet nga një varg shkëmbinjsh rreth 200 metra të lartë dhe rreth 4 km të gjatë. Maja më e lartë e ishullit është Glavina (227 metra), ndërsa thellësia e detit përreth arrin deri në 30 metra. Thellësia më e madhe e matur në bregun lindor arrin deri në 103 metra. Këto karakteristika e bënë ishullin të izoluar në mënyrë natyrore.

Përbërja gjeologjike e mbizotëruar nga shkëmbinj gëlqerorë ishte shkak kryesor për mosekzistimin e burimeve të ujit ose rrjedhjeve të vazhdueshme sipërfaqësore në ishull, që do të thotë se bimësia në ishull ishte gjithashtu e pakët. Pjerrësitë shkëmbore janë të mbuluara vende-vende vetëm nga kullota të thata. Në pjesën jug-perëndimore të Goli Otokut, e cila është më e mbrojtur nga era, filloi pyllëzimi pas krijimit të kampit. Zona e pyllëzuar është sot pjesa e vetme "e gjelbër" e ishullit.

Vetë klima e ishullit tregon se Goli Otok ishte një vend i përshtatshëm për një kamp të këtij lloji. Sipas klasifikimeve, në ishull mbizotëron një klimë mesatarisht e ngrohtë dhe e lagësht, me verë të nxehtë. Në dimër, goditjet e erës janë të shpeshta dhe arrijnë shpejtësinë deri në 150 km/orë, kur temperatura bie në -8°C. Duke marrë parasysh të gjithë tiparet gjeografikë të paraqitur më lart, Goli Otoku ishte një vend i përshtatshëm për të krijuar një kamp burgu. Klima e ashpër do të ngulitej në kujtesën e të burgosurve si një nga karakteristikat kryesore të kampit.

## GOLI OTOK 1949 – 1956

Goli otok ishte kampi më i madh në sistemin e kampeve dhe burgjeve për burgosjen e informbyroistëve. Në gjashtë vitet e ekzistencës së tij, rreth 13,000 persona kaluan nëpër të, ndërsa 287 prej tyre kanë vdekur nga shkaqet e ndryshme. Në periudhën midis viteve 1949 dhe 1956, kishte disa kampe më të vegjël në Goli Otok, tre për burra dhe një për gra. Shërbimi i Sigurimit të Shtetit (UDBA) drejtoi kampin, duke detyruar të burgosurit të abuzonin me të burgosurit e tjerë. I gjithë sistemi në Goli Otok mbështetej në idenë që të burgosurit duhej të denonconin mbështetësit e tjerë të Stalinit në vend dhe të sulmojnë fizikisht dhe verbalisht ata të burgosur që ende mbështesnin Bashkimin Sovjetik. Një sistem i industrisë u krijua në Goli Otok, ku të burgosurit punonin në kushte të rënda pune; në gurëthyes, punëtorinë e drurit, prodhimin e mobileve, nxjerrjen e rërës, riparimin e anijeve të vogla, prodhimin e pllakave, etj. Të burgosurit punonin pjesën më të madhe të ditës në një nga këto fabrika prodhimi, duke siguruar kështu të ardhura për policinë sekrete. Kampi u mbyll në fund të vitit 1956, pas përfundimit të konfliktit me Bashkimin Sovjetik.

Kur bëhet fjalë për kampe të veçanta (të ashtuquajtura vendpunishte) në Goli Otok, duhet theksuar se gjatë një periudhë relativisht të shkurtër midis viteve 1949 dhe 1956, pas nxjerrjes së Rezolutës së Informbyrosë më 1948, qeveria e atëhershme për nevojat e ashtuquajtura të riedukimit politik të të dënuarve (informbyroistëve) e shndërroi ishullin e izoluar në një kamp të fshehtë. Brenda disa viteve, ndërtesa të ndryshme u ngritën dhe u rregulluan në ishull në fshehtësi të madhe, me qëllim të pranimit të të burgosurve, ndërsa shumë shpejt u ngrit edhe fabrika industriale e cila kishte shumë funksione.

Në organizimin e vendeve të zgjedhura me kujdes për izolimin e të dënuarve, ishin vendet të cilat përshtateshin me peizazhin e veçantë të ishullit, ndërsa në të njëjtën kohë ato vende ishin përcaktuar ashtu që t'i shërbejnë në mënyrë të rreptë funksioneve themelore të kampit. Këto vende ishin të rrethuara me tela me gjemba ose të rrethuara me mure të larta dhe përfshinin ndërtesat për strehimin e përbashkët, qelitë indi-

viduale (për izolim), ndërtesat administrative për hetuesit dhe personelin e sigurisë, bunkerët, kullat e vrojtimit për rojet, si dhe zonat për punë të detyruar (gurëthyesi, zonat e pyllëzimit të ishullit dhe zonat bujqësore). Të gjitha këto hapësira dhe ndërtesa mundësuan zbatimin e një jete të izoluar, vendosjen e disiplinës në kamp dhe zbatimin e një sistemi piramidial të administrimit dhe mbikëqyrjes, duke garantuar në masën më të madhe të mundshme, funksionin themelor politik të kampit: riedukimin politik të të burgosurve.

Në Goli Otok kishte katër kampe. Kampi i parë “Teli i Vjetër” (1949 – 1950), kampi i dytë “Teli i Madh” (1950 – 1954) dhe kampi i tretë “R-5 ose Kampi për Gra” (1951 – 1952). Të gjitha këto kampe ishin të vendosur mbi gjiret natyrore të vendeve, si Tatinja, Vela Draga dhe Vela Senjska, midis ishullit të bjerrë, në vendin e veçantë ku ishin formuar gropa shkëmbore nga rrjedhja e përrrenjve karstikë, duke krijuar kështu një vendndodhje natyrore për këto kampe. Ndryshe nga tre kampet e tjera të ishullit, kampi i katërt “Gropa e Petarit” (1950 – 1954), ishte i vendosur në brendësi të ishullit. Sidoqoftë, ky kamp plotësisht i izoluar, i përcaktuar për “informbyroistët e papërmirësueshëm”, ishte i fshehur nga kampet e tjera në Goli Otok në mënyrë që të izolonte këtë grup të veçantë të informbyroistëve nga të dënuarit e tjerë. Kështu u krijua kampi i cili gjendet në një gropë të minierës së braktisur, që ishte punuar dhe gërmuar midis dy luftërave botërore, gjatë gërmimeve në kërkim të boksitit.

Duhet theksuar se Goli Otok ishte kampi më i madh për burgosjen e mbështetësve të vërtetë dhe të pretenduar të Stalinit, në të cilin u burgos numri më i madh i personave. Megjithatë, ai nuk ishte i vetmi. Përveç tij, kishte dy kampe të tjera në ishullin Grgur, një kamp për gra dhe një kamp ku mbaheshin oficerët e Ushtrisë Jugosllave. Përveç kësaj, informbyroistët u internuan edhe në burgjet në Bileqe, Pozharevac, Stara Gradishka, në burgun në ishullin Ugljan dhe në kampin Ramski Rit afër kufirit me Rumaninë. Por, kampi në Goli Otok ishte i vetmi që funksionoi si një vend internimi për informbyroistët gjatë gjithë kohëzgjatjes së konfliktit jugosllav-sovjetik, nga viti 1949 deri në 1956. Gjatë kësaj periudhe, një numër prej 15,737 personave u burgosën në kampe dhe burgje të ndryshme në Jugosllavi me akuzat për mbështetjen e Stalinit.

## GOLI OTOK 1956 – 1988

Duhet bërë një dallim midis kampit në Goli Otok i krijuar me qëllim të “riedukimit politik” të informbyroistëve dhe burgut të mëvonshëm të Goli Otokut. Kampi në fillim ishte nën drejtimin e drejtpërdrejtë të UDBA-s federale, ndërsa burgu i mëvonshëm ishte nën juridiksionin e SUP-it republikan (Sekretariati i Punëve të Brendshme të Republikës Socialiste të Kroacisë). Organizimi dhe qëllimi i burgut ishte i ndryshëm ashtu siç ishte edhe përbërja e të burgosurve. Pas përfundimit të konfliktit me Stalinin, kampi u mbyll për kohësisht, por policia sekrete jugosllave vendosi që prodhimi industrial në ishull të mos mbyllej sepse ishte shumë fitimprurës. Megjithatë, në vitin 1953 kampi në Goli Otok (deri atëherë i quajtur “Vend-punishtja e Mermerit” mori emrin e ri “Burgu korrektues Rab – Goli Otok” dhe pas vitit 1956 filloi të funksionojë në formë burgu për delikuentë, adoleshentë, kriminelë dhe të burgosur politikë. Përbërja e të burgosurve politik në Goli Otok në periudhën pas vitit 1956 përmban vlerësime të ndryshme. Disa nga të burgosurit ishin dënuar me burgim shtesë dhe ishin sjellë sërish në ishull pas vitit 1956. Përveç atyre të burgosurve të kthyer, burgu ka mbajtur një numër të panjohur të të dënuarve të cilët ishin shpallur fajtorë për vepra ideologjike, duke përfshirë shpesh akuzat në lidhje me nacionalizmin etnik. Pavarësisht liberalizimit të Jugosllavisë pas vitit 1955, të burgosurit politik u mbajtën në ishull deri në vitet e ‘80-ta. Pamja e sotme e mbetjeve në Goli Otok daton kryesisht nga koha e burgut, megjithëse ka ndërtesa të shumta që kanë mbijetuar nga koha sa ishte kamp. Burgu i Goli Otokut u mbyll në vitin 1988 dhe pastaj pothuajse plotësisht u shkatërrua.



Ndërtesat e burgut në vendin e ish kampit “Teli i Madh”  
Autor i fotografisë: Darko Bavoljak

## VIZITA E GOLI OTOKUT NË 60 MINUTA



Anijet me të burgosurit, por edhe materiale të ndryshme, më së shpeshti lundronin nga porti i Bakarit dhe arrinin në molin e Goli Otokut, i cili u ngrit gjatë ndërtimit të kampit në vitin 1949. Shpejt u ndërtuan edhe ndërtesa të ndryshme së bashku me infrastrukturën shoqëruese të një limani të vogël, si dhe një dok i vogël i thatë për riparimin e anijeve.

Moli mbeti në kujtesën e të burgosurve për të keq, sepse këtu fillonte kordoni me dy rreshta të cilin të burgosurit duhej ta kalonin; rresht ky që nganjëherë numëronte më shumë se një mijë të burgosur të cilët grushtonin dhe shkelmonin të burgosurit e porsaardhur në kamp. Sipas të dhënave, shumë të burgosur kanë vdekur duke mos arritur të kalonin përmes këtij kordoni.



Fotografia e molit  
Burimi: Arkivi i Shoqatës Goli Otok "Ante Zemljari", autor i panjohur



Fotografia e ndërtesës së ashtuquajtur "Hoteli"  
Burimi: Arkivi i Shoqatës Goli Otok "Ante Zemljari", autor i panjohur

Ndërtesa e ashtuquajtur "Hoteli" është ndërtuar gjatë vitit 1950 dhe ka shërbyer si objekt banimi për hetuesit, anëtarët e UDBA-së (kati i parë), një hapësirë tjetër ku merreshin në pyetje të burgosurit dhe mensa (kati përdhes). Pylli që rrethon ndërtesën e "Hotelit" është rezultat i pyllëzimit që filloi në vitin 1950. Krijimi i kampit nuk ndikoi vetëm në të burgosurit, por ndryshoi edhe mjedisin në Goli Otok. Hapësira përpara ndërtesës fillimisht ishte një shkëmb i zhveshur, siç shihet në fotografi. Administrata e kampit dëshironte të pyllëzonte Goli Otokun, ose të paktën ato pjesë të ishullit ku pyllëzimi ishte i mundur. Dheu u soll nga ishujt e afërt dhe u përdor për të mbjellë pemë, kryesisht pisha. Edhe në këtë rast, policia sekrete ndërthuri riedukimin politik me punën e detyruar. Të burgosurit duhej të qëndronin në një vend për orë të tëra, në mënyrë që të mbronin fidanët nga dielli i fortë.



Me rritjen e numrit të informbyroistëve të burgosur, numri i të burgosurve në Goli Otok gjithashtu u rrit. Kështu që kapacitetet e strehimit në kampin e parë “Teli i Vjetër” ishin të pamjaftueshme, dhe administrata e kampit vendosi të ndërtojë një kamp të dytë më të madh, të njohur si “Teli i Madh” ose ndonjëherë përdorej vetëm si “Teli”. Kampi u ndërtua në vitin 1950 dhe kishte më shumë se 20 pavijone prej guri dhe secili mund të strehonte rreth 250 të dënuar. Kampi “Teli i Madh” ishte i rrethuar me tela me gjemba dhe kulla vrojtimi, si dhe kishte një mol të vogël. U ndërtuan gjithashtu ndërtesa për seksionin kulturor, kuzhina, depo dhe objekti mjekësor. Pas mbylljes së kampit, “Teli” u rindërtua dhe u krijua burgu korrektues në Goli Otok. Ndërtesat origjinale të vitit 1950, siç shihen në fotografi, janë shkatërruar. Pamja e sotme e vendndodhjes së “Telit” kryesisht pasqyron pamjen e burgut nga dekadat e mëvonshme.



Fotografia e kampit “Teli i Madh”  
Burimi: Arkivi i Shoqatës Goli Otok “Ante Zemljari”, autor i panjohur



Fotografia e ndërtesës së Qendrës së vetë-administrimit të kampit  
Autor: Darko Bavoljak

Kampi në Goli Otok kishte një strukturë specifike administrative. Vetë UDBA, policia sekrete e Jugosllavisë, nuk ishte pothuajse asnjëherë e pranishme brenda kampit. Ajo krijoi një sistem të vetë-administrimit të kampit, ku të burgosurit e privilegjuar të kampit administronin të dënuarit e tjerë. U krijua një sistem i tërë privilegjesh dhe një hierarki e brendshme midis të burgosurve, e cila funksionoi si një levë për “riedukimin politik”. Ndërtesa e “Qendrës” që përbënte nivelin më të lartë të vetë-administrimit të kampit, është një nga ndërtesat e pakta origjinale brenda “Telit”. Në këtë ndërtesë, krerët e vetë-administrimit të kampit bashkërendonin detyrat e marra nga UDBA, zbatonin planet e punës ose pranonin të burgosurit dhe bashkëpunëtorët. Ky vend në veçanti urrehej nga të burgosurit e kampit, sepse ata e dinin mirë se të burgosurit e dëgjueshëm të vendosur në “Qendër” ishin dora e zgjatur e UDBA-së. Drejtuesit e “Qendrës” kishin privilegje të shumta që të burgosurit e zakonshëm vetëm mund të ëndërronin: shtretër, ushqim dhe pije të pakufizuar, madje edhe alkool. Ata nuk kishin nevojë të punonin, por urdhëronin të tjerët të punonin. Përndryshe, modele të ngjashme organizative, ku të burgosurit administronin të burgosurit e tjerë në emër të autoritetit, mund të gjendejshin në kampet naziste dhe në gulagët sovjetikë.



Fotografia e mbetjeve të kampit "Gropa e Petarit"  
Autor i fotografisë: Darko Bavoljak

Kampi "Gropa e Petarit", i njohur edhe si "R-101" dhe "Manastiri", përbëhej nga një kazermë e madhe që strehonte rreth 130 persona dhe dy ndërtesa të vogla të gurit për kuzhinën e kampit. Kampi u ndërtua në një gropë të thellë rreth dhjetë metra, një nga disa gropat e tilla të hapura në Goli Otok midis dy luftërave botërore, gjatë gërmimeve në kërkim të boksitit. Të burgosurit e vendosur në Gropën e Petarit ishin kryesisht informbyroistë të dënuar, komunistë të vjetër, udhëheqës të Partisë Komuniste të Jugosllavisë para Titos, persona që kishin kaluar vite shërbimi në Bashkimin Sovjetik, komandantë partizanë të njohur, etj. Të gjithë ata, për shkak të përvojës së tyre të gjatë në parti, nuk ishin përkrah Titos dhe kryesisht mbështetnin Stalinin. Në mënyrë që t'i izoloni nga të burgosurit e tjerë, ata u vendosën në këtë vend të vetmuar ku iu nënshtruan torturave të rënda. Pas shpërbërjes së Kampit, vendi u rrafshua duke e mbuluar me dhe. Fotografia tregon vendin ku me shumë gjasa ndodhej kampi "Gropa e Petarit".

Të burgosurit e mbajnë mend etjen si një nga problemet më të rënda në Goli Otok. Prandaj, një nga detyrat më të mira që një i burgosur mund të merrte në kamp ishte roli i "ujëmbartësit". Detyrë e tyre ishte që të ndanin ujin gjatë vakteve të ushqimit ose punës. Ky person mund të vendoste t'u jepte të burgosurve me pak ose më shumë ujë. Ai mund të pinte ujë vetë, kur të donte dhe sa të donte, por ai ishte gjithmonë në rrezik nga të burgosurit e tjerë. Të gjithë e dëshironin pozitën e tij dhe ishin të gatshëm të bënin gjithçka për ta arritur atë. Thjesht, nuk kishte kurrë ujë të mjaftueshëm. Përveç ndëshkimit që ndonjëherë kryhej në formën e racioneve të reduktuara të ujit, nga ana logjistike ishte e vështirë për të sjellë ujë në Goli Otok. Për këtë qëllim, ekzistonte një anije transportuese e ujit e quajtur "Izvor" ("Burimi") që furnizonte kampin me ujë. Një nga mënyrat për t'u marrë me problemin e mungesës së ujit në ishull ishte ndërtimi i një sipërfaqe të madhe të pjerrët që do të shërbente si një rezervuar për kapjen dhe ruajtjen e ujit të shiut.

Fotografia e rezervuarit të ujit  
Autor i fotografisë: Darko Bavoljak





Goli Otok nuk ishte vetëm një vend ku njerëzit torturoheshin dhe internoheshin, por edhe një kompleks shumë i zhvilluar industrial. Që nga fillimet e kampit, policia sekrete përdori të burgosurit e kampit për detyra të ndryshme: nga ndërtimi i kampit, pyllëzimi i ishullit, deri në nxjerrja e gurit për nevoja të ishullit. Me kalimin e kohës, degë të tjera të prodhimit u zhvilluan, të tilla si përpunimi i gurit, hekurit, drurit, riparimi i anijeve dhe nxjerrja e rërës. Policia sekrete, UDBA, fitoi shumë para nga tregtia me produkte dhe lëndë të parë të ishullit. Punëtori të shumta u krijuan në vendin e kampit të parë "Teli i Vjetër", të cilat pas vitit 1956 u zhvendosën në vendndodhjen afër molit. Një fakt interesant është se për një kohë të gjatë Goli Otoku ishte një fabrikë për prodhimin e pllakave terrazzo dhe se produktet e saj janë përdorur për të mbuluar me pllaka shumë institucione publike në të gjithë vendin.

Fotografia e punëtorisë në Goli Otok  
Autor i fotografisë: Darko Bavoljak



Fotografia e Ndërtesës prej Guri  
Autor i fotografisë: Darko Bavoljak

Ndërtesa prej guri është ndërtesa e parë prej guri e ngritur në Goli Otok. Ajo u ndërtua në vitin 1949 nga të burgosurit për nevojat e vendosjes së administratës së kampit dhe hetuesve. Pas përfundimit të ndërtimit të një objekti të ri dhe më të madh për të vendosur administratën dhe hetuesit në vitin 1950 (shih pikën 2), ndërtesa prej guri u përdor për të strehuar rojet. Në periudhat e mëvonshme, ndërtesa prej guri shpesh ndryshonte funksionin e saj.

## VERA WINTER (1923-2015)



Burimi: Albumi privat i familjes Winter

Vera Winter, e lindur Barishiq, ishte një nëpunëse e re në një nga ministritë federale në Beograd kur u nxor Rezoluta e Informbyrosë në verën e vitit 1948. Një nga eprorët e saj ishte simpatizant i Stalinit, gjë që mjaftonte që edhe ajo të konsiderohej si e dyshimtë. Ajo u arrestua shumë shpejtë pasi u tha në mënyrë naive dy zyrtarëve të UDBA-së në zyrën e saj, se ajo dëgjonte Radio Moskën. Pas një hetimi të ashpër, ajo u dëbua në kampin për gra në Goli Otok.

*“Ato ishin me fat. Unë isha në një brigadë që bartte gur nga bregu i detit deri në kodër. Gjëja e vështirë, përveç bartjes së gurit, ishte se nuk kishim fare këpucë, por vetëm një palë opinga gome. Këto në fakt ishin goma të vjetra të makinës që i lidhnim me diçka për këmbë. Tmerr. Dhe pas një kohe të shkurtër, gjaku filloi të rridhte nga këmbët e mia, kështu që grisa bluzën time që të bëja sandalet (...) Gjëja më e vështirë për mua ishte puna e rëndë fizike pa pushim. Bartja e vazhdueshme e gurëve ose qeseve të çimentos nga mëngjesi në mbrëmje. Deri vonë, unë mund të shihja shenja plagësh, disa mund të shihen edhe sot, edhe pse kanë kaluar 60 vjet. Kjo është e para. E dyta ishte lodhja psikologjike, aq sa shkatërrohesha nga brenda. Nuk munda më, i thashë vetes, do të bëj gjithçka që kërkojnë nga unë vetëm që të vdisja në atë çast. A mund ta përfytyroni një gjë të tillë?”*

Pjesë nga intervista me Martin Previsihqin, Zagreb, 2009.

## KAMPI PËR GRA

Gjatë konfliktit me Stalinin, 862 gra u burgosën dhe internuan në kampe. Akuzat e ngritura kundër tyre ishin pothuajse të njëjta me ato të ngritura kundër burrave. Që nga çasti i arrestimit, gratë mbaheshin të ndara fizikisht nga burrat. Gjatë kryerjes së hetimeve, ato mbaheshin në burgje të veçanta, d.m.th. në pjesë të veçanta të burgut. Ato u gjykuan në procese të veçanta gjyqësore dhe u transportuan në kampe dhe burgje ku vazhduan të mbahen të ndara nga burrat. Kampi i parë ku u mbajtën ishte Ramski Rit, në kufirin e Jugosllavisë me Rumaninë, i cili ekzistoi nga gushti 1949 deri në janar 1950. Kampi ishte i vendosur në një zonë moçali afër një shteti i cili në atë kohë ishte armiqësor, kështu që të burgosurat shpejt u transferuan në burgun Zabela në Pozharevac. Më pas, gratë u zhvendosen në kampin në ishullin Sveti Grgur, ku kaluan rreth një vit, nga prilli 1950 deri në prill 1951, dhe pastaj u transferuan në Goli Otok në kampin “Radilishite 5” (Vend-punishtja 5, R-V). Këtu përsëri kaluan një vit. Gjatë kësaj kohe, megjithëse gjendeshin në të njëjtin ishull me burrat, ato nuk kishin asnjë kontakt me ta. Sipas dëshmitare të ish të burgosurve të kampit, të dy grupet vetëm herë pas here shikonin njëri-tjetrin nga larg. Kampi për gra në Goli Otok ishte i vendosur në një vend veçanërisht të paarritshëm, me kushte të rënda të motit, meqë ishte i ekspozuar ndaj erërave të vazhdueshme. Ngjashëm me strukturën e administrimit të kampeve të burrave, hetueset ishin gra dhe kushtet e jetesës dhe punës ishin të vështira. Pas Goli Otokut, të burgosurat u transferuan përsëri në ishullin fqinj Sveti Grgur, ku qenë dëshmitare të shpërbërjes së sistemit të kampit dhe më pas lirimit të tyre.



Fotografia e mbetjeve të kampit për gra në Goli Otok  
Autor i fotografisë: Darko Bavaljak





Fotografia e punëtorive të dikurshme në Goli Otok,  
fotografuar nga ajri  
Autor: Bruno Loje

## ALFRED PAL (1920 - 2010)



Autor i fotografisë: Darko Bavoljak

Alfred Pal ishte tipograf dhe artist. Pjesa më e madhe e familjes së tij humbën jetën gjatë holokaustit, ndërsa ai vetë ishte i burgosur në kampet italiane dhe ustashe. Në vitin 1943 u bashkua me partizanët komunistë. Pasi filloi konflikti me Stalinin, ai kaloi gati katër vjet në Goli Otok. Ai u arrestua në vitin 1949 si mbështetës i Rezolutës së Informbyrosë, ndërsa u lirua në vitin 1953. Më vonë, ai do të kujtonte atë që e kishte më të vështirë në kamp:

*“Për mua personalisht, gjëja më e vështirë për Goli Otokun ishte të mbetem njeri. Besoj se kështu ishte për të gjithë, sepse ajo që kërkohet nga individit ishte e kundërta e asaj që pritet nga një njeri normal. Nuk doja ta bëja atë dhe ashtu qëndrova deri në fund. Nuk doja të tradhetoja shokët e mi, nuk doja të rrahja të dënuarit e tjerë, nuk doja të vrapoja te hetuesit për të denoncuar. Kam paguar çmimin. Tre herë i jam nënshtruar bojkotit të detyrueshëm shoqëror, më rrahën disa herë dhe në fund isha sinonim “i bandës”. Ky ishte çmimi, por unë nuk doja të lëkundesha vetëm që të mbetem njeri në Goli”.*

Pjesë nga intervista me Martin Previsihqin, Zagreb, 2009.

## GOLI OTOKU – SEKRETI PUBLIK JUGOSLLAV

Policia sekrete e Jugosllavisë u ndaloi të burgosurve të liruar të flisnin për Goli Otokun dhe përvojat e tyre në kamp. Para se të liroheshin, të burgosurit duhej të nënshkruanin dokumentin e ashtuquajtur “Zotim” me të cilin detyroheshin të heshtnin për atë që kishte ndodhur në kamp, nën kërcënimin se do të burgosen përsëri. Ata që u liruan, kryesisht flisnin për Goli Otokun vetëm me ata persona në të cilët kishin besim të madh. Në këtë mënyrë, Goli Otoku ishte një sekret publik jugosllav për një kohë të gjatë. Tema e konfrontimit me mbështetësit e Stalinin filloi të shfaqej për herë të parë në letërsi në fund të viteve 1960, në romanin e Dragoslav Mihailoviçit “Kur lulëzuan kungujt” (Dragoslav Mihailović „Kada su cvetale tikve”). Pas vdekjes së Titos në vitin 1980, u botuan dhjetëra romane (Isaković, Hoffman, Selenić, Mihailović) që bazoheshin në dëshmitë e ish të burgosurve, të cilët hapën këtë temë në vitet e liberalizimit gradual të shoqërisë. Në të njëjtën kohë, pati jehonë shumë të shkurtër dhe të vonuar nga historiografia zyrtare, si dhe një falje të personave që ishin pjesë e aparatit të sigurimit shtetëror nga koha e konfliktit Tito-Stalin, të cilët justifikonin ekzistencën e kampeve të internimit duke pretenduar se “pa Goli Otokun, e gjithë Jugosllavia do të shndërrohej në një Goli Otok”. Në fillim të viteve 1980, shtypja dhe dhuna që shënoi periudhën e konfliktit me Stalinin u bënë temë e filmave artistikë, midis të cilëve më të popullarizuarit ishin “Spiuni i Ballkanit” dhe “Babai në udhëtim zyrtar” (“Balkanski špijun” dhe “Otac na službenom putu”). Dalja në dritë e filmave, dëshmitë dhe e ashtuquajtura “letërsia e Goli Otokut”, ndikoi fuqishëm në shoqërinë jugosllave, e cila tashmë po përballlej me kriza të ndryshme. Pavarësisht nga konteksti historik i kampit, zbulimi i informacioneve rreth torturave në Goli Otok dhe aparatit brutal shtypës, zhgënjyeshëm më tej shumë njerëz, duke kontribuar kështu në thellimin e krizës së besimit në rendin komunist jugosllav. Megjithatë, për shkak të shpërbërjes së Jugosllavisë, tema e kampit mbeti e pastudiuar sa duhet dhe me shumë pak interes për trashëgiminë e dikurshme edhe nga shtetet e reja pasardhëse.



## VLADIMIR BOBINAC (1923-2014)



Autor i fotografisë: Zoran Petrić

Vladimir Bobinac u arrestua si student i historisë në Fakultetin Filozofik në Zagreb. Ai kaloi dy vjet në Goli Otok. Pas ndryshimeve demokratike në vitet 1990, kur u lejua hyrja në Goli Otok, Bobinac filloi të organizonte grupe private të vizitorëve në Goli Otok. Deri në vdekjen e tij, ai iu tregoi ishullin mijëra njerëzve duke ndarë përvojat e tij nga kampi. Vladimir Bobinac përshkroi përvojën e tij nga Goli Otoku në fjalët e mëposhtme:

*“Goli Otoku është masa e njerëzve. Goli nuk është Alfred Pal, Pavle Ravliq ose unë. Goli nuk është një individ, sepse ai është masa. Goli është rrahja e shokut nga shokët e tij të luftës, denoncimi i njëri-tjetrit. Kjo është vështirë të përshkruhet. Goli është si filmi i Eisensteinit për rebelimin e detarëve në Odessa, ku asnjë aktor kryesor nuk është me dhëmbë të bukur, por ku rolin kryesor e luajnë masa. Në Goli nuk ka heronj, sepse nuk mund të jesh hero për dy ose më shumë vjet. Heroi vdes ose nuk vdes në çast, ndërsa vdekja në Goli zgjat për vite me radhë. Mund të vuani vetëm deri në një pikë të caktuar pas së cilës ju pengoheni dhe bëheni pjesë e një turme të tërbuar që lufton dhe kërcënon njëri-tjetrin. Kushti i vetëm për të mbijetuar është të bëhesh pjesë e kësaj turme. Vështirë është të përshkruash se si sistemi i Goli Otokut e ndryshoi njeriun për ta bërë atë të bënte gjithçka që duhej të bënte. Kjo është pikëpamja ime për të gjitha.”*

Pjesë nga intervista me Martin Previshiçin, Krk, 2010.

## GOLI OTOKU NË KULTURËN BASHKËKOHORE KROATE TË KUJTESËS

Goli Otoku është një nga vendet me rëndësi të madhe historike dhe simbolike në historinë bashkëkohore të Kroacisë. Ishulli i shkretë poshtë malit të Velebitit është vendi kryesor i shtypjes së disidentëve nga ana e regjimit komunist jugosllav. Megjithatë, përkundër rëndësisë së tij historike dhe simbolike, për ekzistencën e kampit të dikurshëm, më vonë burgut, sot dëshmojnë vetëm ndërtesat e shkatërruara dhe të rrënuara që janë duke u shembur në shkëmbinj të ishullit. Një vizitor i kujdesshëm në ishull do të vërejë disa tabela informacioni, gjegjësisht pllaka për kujtimore kushtuar viktimave, si dhe tabela me përmbajtje turistike dhe hoteliere të pakëndshme. Në këtë fazë mund vetëm të ëndërrohet për një muze apo institucion arsimor që do të merrej me temën e Goli Otokut, në bazë të standardeve kërkimore-shkencore, muzeologjise dhe pedagogjise.

Shkatërrimi i kampit të dikurshëm, më vonë burgut, ilustron qartë qëndrimin e shtetit kroat dhe shoqërisë kroate ndaj Goli Otokut dhe viktimave të tij. Sot, Goli Otoku dhe viktimat e tij janë vetëm një nga shumë çështje dytësore në kulturën e kujtesës, të lënë nën kujdesin e disa entuziastëve që shpesh historia familjare i lidh me këtë temë të dhimbshme. Duke pasur parasysh rëndësinë e adresimit të diktaturave në ndërtimin e një kulture politike demokratike, si dhe rolin e spikatur të shtypjes komuniste në kulturën e kujtesës në shumë shoqëri bashkëkohore post-komuniste në Evropë, shtrohet pyetja pse ndodh kështu.

Arsyet për dukshmërinë modeste të Goli Otokut në kulturën e kujtesës kroate janë të shumta. Duke folur për përfaqësimin marginal të temës së Goli Otokut në kulturën kroate të kujtesës dhe shprehjen e rrallë të ndjeshmërisë ndaj viktimave, së pari duhet thënë që qëndrimi ambivalent ndaj viktimave të kampit daton qysh nga periudha e Jugosllavisë socialiste. Një kombinim i mungesës së njohurisë për rrethanat e arrestimeve, dëbimeve dhe kushteve të qëndrimit në Goli Otok nga njëra anë, dhe frika nga pushtimi Sovjetik dhe pasojat e tij nga ana tjetër, kanë rezultuar në ngritjen e pyetjeve të dyshimta që ende sot vazhdojnë të krijojnë opinionin publik mbi këtë temë. Disa nga këto pyetje janë:

A ishin të burgosurit në Goli Otok të burgosur politikë apo kriminelë të zakonshëm? Nëse do të ishin të burgosur politikë, a ishin vërtet mbështetës të zjarrtë të Stalinit? Nëse do të ishin stalinistë, çfarë tjetër do të mund të bëhej përveç internimit të tyre në një vend të izoluar? Nëse nuk ishin stalinistë, si u gjendën ata në situatën ku do të arrestoheshin dhe burgoseshin?

Është e vërtetë se disa nga të burgosurit në Goli Otok ishin mbështetës të zjarrtë të Stalinit, gjë që e ndërlikon situatën për njohjen e statusit të viktimës të atyre të burgosurve që përfunduan vetëm në Goli Otok, sepse ata u denoncuan me keqdashje si mbështetës të Rezolutës së Informbyrosë. Elitat politike të Jugosllavisë komuniste u përpoqën të fshihnin ose të justifikonin dhunën politike kundër kundërshtarëve të tyre, gjë që pjesërisht shpjegon qëndrimin ambivalent ndaj Goli Otokut në Jugosllavinë socialiste. Heshtja, krijimi arbitrar i justifikimeve dhe shpifjeve ndaj kundërshtarëve politikë janë strategji e legjitimitetit të çdo diktature.

Sidoqoftë, përgjigja në pyetjen pse viktimat e dhunës politike në Goli Otok ende nuk kanë gjetur respektin e duhur dhe njohjen e gjerë shoqërore, në rendin e sotëm demokratik dhe



Ndërtesa në Goli Otok, 2018  
Autor i fotografisë: Boris Stameniq

*Pas mbylljes së burgjeve dhe largimit të të burgosurve të fundit në fund të viteve të '80 të shekullit të 20-të, ishte planifikuar të ndërtohej një vendpushim turistik në ishull, por planet për zhvillimin e turizmit në ishull u ndërpre në pas shpërthimit të luftës në Kroaci në vitin 1991. Megjithatë, jashtë zonave të prekura nga konflikti ushtarak, ndërtesat e ish-burgut në Goli Otok u plaçkitën, shkatërruan dhe harruan plotësisht. Bujqit nga vendbanimet përreth përdorin Goli Otokun për të kullotur delet e tyre, të cilat mund të enden nëpër ishull pa u penguar.*

post-komunist, kërkon një kuptim më të hollësishëm të kulturës bashkëkohore kroate të kujtesës, si dhe të vlerave dhe ideologjisë së shoqërisë bashkëkohore kroate.

Arsyeja e parë për marginalizimin e Goli Otokut në kulturën kroate të kujtesës qëndron në përbërjen etnike të të burgosurve. Pas vitit 1990, politika etnocentrike e historisë mbizotëroi në shoqëritë post-komuniste. Përqindja relativisht e ulët e kroatëve në mesin e të burgosurve nuk e cilëson atë si një vend të vuajtjes kombëtare.

Arsyeja tjetër qëndron në orientimin ideologjik të viktimave. Pavarësisht nëse ata ishin apo nuk ishin mbështetës të Rezolutës të Informbyrosë, shumë prej të burgosurve ishin komunistë të bindur, Jugosllavë dhe veteranë të Luftës Nacionalçlirimtare. Ky fakt gjithashtu ka pasur një ndikim negativ në perceptimin e tyre nga një pjesë e shoqërisë kroate. Për shkak të orientimit ideologjik të një numri të madh të të burgosurve, Goli Otoku nuk është i përshtatshëm në rrëfimet e reja të historisë. Megjithëse është njohur dhe pranuar publikisht si një simbol i dhunës në Jugosllavinë komuniste, Goli Otoku nuk paraqet një element kryesor të diskursit antikomunist në Kroaci, i cili si pasojë zvogëlon dukshmërinë e tij të përgjithshme.

Arsyeja e tretë për marginalizimin e Goli Otokut në kulturën kroate të kujtesës është Lufta Kroate për Pavarësi (1991-1995), dhe fakti që lufta për pavarësinë e Kroacisë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, ishte afirmuar si vlerë kryesore dhe simbol i identitetit të shoqërisë kroate. Lufta në kontekstin e shpërbërjes së rendit socialist dhe federatës shumëkombëshe është një përvojë kolektive që e dallon Kroacinë nga shumica e shoqërive post-komuniste në Evropë, si dhe pjesërisht shpjegon edhe dallimet në qëndrime ndaj çështjes së përkujtimit të së kaluarës bashkëkohore.

Nga ana tjetër, duhet theksuar se përvoja e shumëfishtë e luftërave dhe e dhunës së motivuar ideologjikisht në shekullin 20-të, në territorin që sot i përket Kroacisë, manifestohet në një trend të ngadaltë por të dukshëm të pluralizimit të kulturës kroate të kujtesës dhe të bashkëjetesës së antitezave dikur të papajtueshme. Megjithëse, në parim është një proces pozitiv, pluralizimi i kulturës së kujtesës gjithashtu rezultoi në krijimin e perceptimit të konkurrencës midis viktimave dhe një ndjenjë në mesin e një pjesë të publikut se "ata kujdesen vetëm për viktimat e tyre; ata nuk i shohin ose njohin viktimat tona", gjë që çon në ndarje dhe konflikte të reja.



Shkalla në të cilën dhuna politike dhe viktimat e saj zënë vend në jetën e publikut është e dukshme nga komentet e hidhura në portalet dhe rrjetet sociale. Anonimiteti i pjesëmarrësve në diskutimet në internet siguron që kontribuon në radikalizmin e pikëpamjeve të shprehura që shpesh kalojnë në fyerje dhe kërcënime. Në të njëjtën kohë, gjithnjë e më shumë ka njerëz tërhiqen nga diskutimet në hapësirën publike, qoftë të frikësuar nga gjuha e urrejtjes, apo me pretendimin se nuk janë të interesuar për histori dhe politikë. Në rrethana të tilla, viktimat e dhunës politike shpesh bien në harresë, ose bëhen krejtësisht të parëndësishëm.

Është pozitive që zyrtarët qeveritarë, ose të paktën të dërguarit e tyre, mund të shihen në përvjetorët përkujtimor në Goli Otok. Përfaqësuesit e institucioneve politike të Republikës së Kroacisë vizitojnë Goli Otok më së shpeshti më 23 gusht, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit për Viktimat e Regjimeve Totalitare dhe Autoritare. Megjithatë, midis dërgimit të përfaqësuesve me një kurorë lulesh dhe ndërtimit të një muzeu dhe infrastrukture arsimore me personel dhe programe të kualifikuar, ka një rrugë të gjatë që kërkon investime të konsiderueshme dhe gatishmëri të palëve të ndryshme politike dhe shoqërore për të mbështetur këtë proces.



Fotografia e portës në Goli Otok, 2018  
Autor i fotografisë: Boris Stameniq

*Përkundër mungesës së një institucioni përkujtimor dhe përmbajtjeve shoqërore, interesimi i vizitorëve vendas dhe të huaj për të parë Goli Otokun ka nxitur zhvillimin e infrastrukturës turistike të organizuar nga ndërmarrës nga vendet përreth si Kirk, Rab, Senj dhe Jurjevo. Kampi i dikurshëm, gjegjësisht burgu në Goli Otok, përdoret për të reklamuar ekskursione dhe suvenire të punuara, që banalizojnë vuajtjet e të burgosurve në Goli Otok. Vizitorët mund të shëtisin nëpër shtigjet e gurit në ishull në një rimorkio të tërhequr nga një traktor me mbishkrimin "Goli Express" [sic]. Vizitorët mund të blejnë pije freskuese në një objekt hotelierie të quajtur "Pržun" (Przhun), që në dialektin vendor do të thotë "Burg". Ishulli herë pas here vizitohet nga të ashtuquajturat "Anije për festim" me muzikë me zë të lartë.*

## Literaturë

- Banac, Ivo. *Sa Staljinom protiv Tita*, Zagreb 1990.  
Bilić, Đuro. *Goli otok i Dabrovine*, Zagreb 1998.  
Bobinac, Vladimir. *Informbiroovac: uspomene iz Titova Alcatraza*, Zagreb 2017.  
Ćuruvija, Slavko. *Ibeovac: ja, Vlado Dapčević*, Beograd 1990.  
Ercegović Miloš, Josip. *Šest godina u paklu Golog otoka*, Rijeka 2002.  
Hrast, Radovan. *Viharnik na razpotjij časa*, Ljubljana 2007.  
Isaković, Antonije. *Tren 2*, Beograd 1982.  
Jovanović, Dragoljub. *Muzej živih ljudi - Tom I*, Beograd 1990.  
Lebl, Ženi. *Ljubičice bela – Vic dug dve i po godine*, Gornji Milanovac 1990.  
Mihailović Dragoslav. *Kad su cvetale tikve*, Beograd 1987.  
Mihailović, Dragoslav. *Goli otok 1*, Beograd 1990.  
Marković, Dragan. *Istina o Golom otoku*, Beograd 1987.  
Nikčević, Tamara. *Goli otoci Jova Kapičića*, Beograd 2010.  
Previšić, Martin. *Povijest Golog otoka*, Zagreb 2019.  
Simić, Mihajilo. *Na Golom otoku*, Beograd 1990.  
Zemljar, Ante. *Pakao nade*, Zagreb 1997.

## Impresum

Friedrich-Ebert-Stiftung  
Zyra Rajonale për Kroacinë dhe Slloveninë  
Praška 8, HR 10000 Zagreb, Croatia


Për botuesin: Turkan Karakurt, E-mail: [tuerkan.karakurt@fes.hr](mailto:tuerkan.karakurt@fes.hr)  
[www.fes.hr](http://www.fes.hr)

Foto: Arkivi i Shoqatës Goli Otok "Ante Zemljar", arkivi privat i dr. Martin Previsihiqit, albumi privat i familjes Winter, Darko Bavoljak, dr. Boris Stameniq, Bruno Loje, Administrata Shtetërore e Gjeodezisë  
Fotografia në ballinë: Kullë vrojtimi në Goli Otok. Autor: Darko Bavoljak  
Viti: 2020.

Ndalohet përdorimi tregtar i çdo materiali të botuar nga Friedrich-Ebert-Stiftung (FES), përveç me leje paraprake nga FES. Pikëpamjet e paraqitura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e FES-it ose organizatave në të cilat punojnë autorët.

# GOLI OTOK 1949 - 1956

0 50 100 500m



## Autorët:

---

**Martin Previshiç** është docent në Departamentin e Historisë të Fakulteti Filozofik në Universitetin e Zagrebit. Është ligjërues i lëndës së historisë bashkëkohore të Kroacisë dhe Jugosllavisë pas vitit 1945. Tezën e doktoratës me titull “Historia e kampit të Informbyrosë në Goli Otok 1949-1956” e mbrojti në vitin 2014 në Fakultetin Filozofik në Zagreb.

**Boris Stameniq** është koordinator i programit “Kultura e Kujtesës” në organizatën “Documenta - Qendra për Ballafaqimin me të Kaluarën” dhe ligjërues dhe trajner në fushën e edukimit qytetar. Tezën e doktoratës me titull “Jeta politike e një loje. Sinjska alka si medium i legjitimitetit politik në shekullin e 20-të”, mbrojti në vitin 2015 në Universitetin Humboldt në Berlin.

**Vladi Braliq** është themelues dhe drejtor i zyrës projektuese “Arhitektonsko-građevinski atelje” (Studio Arkitektonike dhe Ndërtimore) në Rijekë. Ai diplomoi në Fakultetin e Arkitekturës në Zagreb. Në kuadër të studimeve të doktoratës në të njëjtin fakultet, ai është duke përgatitur disertacionin mbi arkitekturën e kampit për të burgosurit politikë në Goli Otok.